



QENDRA E TRAJNIMEVE
& BURIMEVE PËR AVOKIM



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



THE ADVOCATE

Përkrah Organizatat Jo-qeveritare

Vëllimi V • Numri 10 • Dhjetor 2007

ATRC shpërblen dy gazetarë për raportim mbi dhunën familjare

PËRMBAJTJA

Faqe 1

ATRC shpërblen dy gazetarë për raportim mbi dhunën familjare

Faqe 2

ATRC trajnon zyrtarët komunal dhe OJQ-të për negociata

Rezultatet e Shoqatës së Personave të Verbër dhe me të Pamë të Dobësuar të Kosovës
Dy parti politike prezantuan programet elektorale në alfabetin e Brailit për të ofruar informata të mjaftueshme për të verbëritë

Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së:
www.advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

Gazetarja e Infopress-it Antigona Uka është shpërblyer për storien më të mirë të publikuar, dhe gazetarja e Radio Kosovës Hyrë Tejeci për storien më të mirë të transmetuar për raportim mbi barazinë gjinore dhe dhunën familjare. Shpërblimet, e ndara nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), janë shpallur gjatë një ceremonie shpërblyese të mbajtur në ATRC më 12 dhjetor, me qëllim që të njihet publikisht kontributi i gazetarëve, të cilët nëpërmjet storiave të tyre kanë trajtuar dhunën ndaj grave/dhunën familjare.

"Këto shpërblime ndahen duke ditur situatën financiare në media, duke e ditur që gazetarët nuk marrin paga që meritojnë. Dëshirojmë ti përkrahim gazetarët që raportojnë për këto çështje me interes për popullin e Kosovës, çështje që nganjëherë harrohen", ka thënë gjatë ceremonisë Frode Muring, përfaqësues i UNDP-së.

Njëmbëdhjetë gazetarë me 13 storie kanë garuar për storien më të mirë gazetareske për barazi gjinore, dhunë ndaj grave dhe dhunë familjare, të publikuar ose transmetuar në mediat kosovare gjatë periudhës 7 tetor deri më 7 dhjetor, 2007.

Trembëdhjetë zyrtarëve komunal për çështje gjinore dhe 11 gazetarëve u janë ndarë certifikata gjatë ceremonisë nga Rreze Duli, drejtoreshë e ATRC-së, për pjesëmarrje të suksesshme në trajnimet e ATRC-së të mbajtura në tetor dhe nëntor lidhur me barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën familjare. Dy trajnimet kanë përfshirë komponentë për të drejtat e njeriut, të drejtat e grave, barazinë gjinore, dhunën ndaj grave (DhNG), legjislacionin aktual kundër DhNG-së në Kosovë, etj.



Zyrtarët komunal dhe gazetarët në ceremoninë e shpërblimeve dhe certifikatave më 12 dhjetor

Trajnimet kanë synuar ngritjen e vetëdijes së gazetarëve dhe përgjegjësisë së tyre në promovimin e imazheve jo stereotipe të grave dhe burrave, dhe të trajnojnë zyrtarët komunal për lobim, avokim, shtim fondesh dhe bashkëpunim me akterët e tjerë në nivel komunal për të përmirësuar koordinimin me OJQ-të e grave dhe të bëhen zëri i tyre.

Iniciativa është realizuar nga ATRC dhe Iniciativa për Sigurinë e Grave, e përkrahur nga UNDP.

Për më shumë informata, kontaktoni info@advocacy-center.org

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Executive Director
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org

**Financial & Administration
Manager**
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org

Grant Manager
KUSHTRIM KALOSHI
kushtrimk@advocacy-center.org

Grant Officer
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

Grant Finance Manager
SAFETA XHEKOVIC
safeta@advocacy-center.org

**Training & Consultancy
Services Manager**
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
AFERDITA SURROI
aferdita@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
KUSHTRIM ISLAMI
kushtrim@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
NORA SUSURI
nora@advocacy-center.org

**Communication & Outreach
Manager**
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org

IT and Database Manager
ARSIM KOSUMI
arsim@advocacy-center.org

ATRC trajnon zyrtarët komunal dhe OJQ-të për negociata

Trajnerët e ATRC-së kanë realizuar shtatë trajnime për negociata në rajonin e Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Prizrenit, Mitrovicës, Gjakovës dhe Ferizajit gjatë periudhës shtator-dhjetor 2007. Trajnimet "Zgjidhja e Konfliktit Social - negociatat dhe rrjetëzimi" për zyrtarë komunash dhe OJQ-

të, bashkuan këta dy sektorë në një grup në secilin rajon të Kosovës. Iniciativa ka pasur për qëllim ti ndihmoj qeverisë lokale dhe shoqërisë civile në themelimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve me qëllim të reagimit më të mirë ndaj nevojave të komuniteteve të tyre nëpërmjet mjeteve dhe teknikave të zgjidhjes së konfliktit/negociatave. Trajnimet kanë përfshirë sesione mbi përgatitjen dhe rezultatet e negociatave, negociatat asimetrike, ndërmjetësi-

min, delegacionin, etj.

ATRC beson se ndërtimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy sektorëve do të shërbente edhe si bazë për projekte të tjera që kanë të bëjnë me demokracinë dhe ruajtjen e paqes në Kosovë. Shtatë trajnimet për negociatat kanë pasuar 14 trajnime për përfaqësues të qeverive lokale dhe OJQ-ve gjatë gjysmës së parë të 2007-ës të cilat janë përqendruar në kuptimin dhe ballafaqimin me konfliktin, komunikim, konflikt social, ndryshim dhe demokraci, bashkëpunim, etj.



Sesion trajnimi për negociata më 7 nëntor

Iniciativa është përkrahur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.

Rezultatet e Shoqatës së Personave të Verbër dhe me të Pamë të Dobësuar

Dy parti politike prezantuan programet elektorale në alfabetin e Brailit për të ofruar informata të mjaftueshme për të verbëritë

Shoqata e Personave të Verbër dhe me të Pamë të Dobësuar të Kosovës ka avokuar gjatë tetorit dhe nëntorit për të siguruar qasje të plotë të personave me aftësi të kufizuara, posaçërisht personave të verbër, në procesin zgjedhor.

Shoqata ka ndërmarr disa iniciativa për ta informuar komunitetin e të verbërve dhe me të pamë të kufizuar për zgjedhjet dhe procedurat e votimit, fokusuar në përfshirjen e alfabetit të Brailit në programet dhe dokumentet lidhur me zgjedhjet parlamentare dhe lokale, të mbajtura më 17 nëntor.

Takimet me përfaqësues të partive politike garuese në këto zgjedhje kanë rezultuar me prezantimin e programeve politike në alfabetin e Brailit të Partisë Reformiste "Ora" dhe Aleancës për

Ardhmërinë e Kosovës "AAK".

Me qëllim të ofrimit të informatave të mjaftueshme të verbërve për procesin zgjedhor dhe programet e partive politike, në tetor dhe nëntor Shoqata ka organizuar trajnim për personat me aftësi të kufizuara për procesin e votimit, shtatë tryeza të rumbulakëta dhe radio debate në shtatë rajone të Kosovës, në të cilat morën pjesë përfaqësues të Komisionit Qendror Zgjedhor, partive politike, OJQ-ve dhe personave me aftësi të kufizuara.

"Iniciativa jonë ka shërbyer për të ngritur vetëdijen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë për rëndësinë e votimit në këtë proces demokratik, përkundër mungesës së kushteve adekuate për votim pa asistencë", ka deklaruar Bujar Kadriu, drejtor i Shoqatës.

Iniciativa ishte pjesë e projektit "E Drejta për Votë" e përkrahur nga ATRC dhe IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile.

Për shumë informata, vizitoni www.shoqataeteverbereveekosoves.org

